

Vendim nr. 306 datë 17.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 17.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (M) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **MARKELJAN DOÇI, KLEJVI DOÇI**, përfaqësuar nga avokatët Emin Saraçi dhe Marsilda Petrela.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 105, datë 10.10.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; nr. 23, datë 13.03.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë; nr. 00-2024-427 (62), datë 07.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 16, pika 2, 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Klejvi Doçi dhe Markeljan Doçi janë akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me paramendim”, kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit D.S. dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 78, paragrafi 2 dhe 278, paragrafi 5, të Kodit Penal (KP). Ngjarjet kundrejt të cilave janë akuzuar kërkuesit janë zhvilluar në datën 06.04.2015 në Seringenplatsoen, Ridderkerk – Holandë, ku është vrarë me armë zjarri shtetasi shqiptar D.S. Gjithashtu, kërkuesi Markeljan Doçi është akuzuar edhe për kryerjen e veprës penale “Vrasja e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, të parashikuar nga neni 83 i KP-së, në dëm të shtetasit B.D. Kjo ngjarje ka ndodhur në datën 27.05.2015 në qytetin e Tiranës, ku, ndër të tjerë, është vrarë edhe shtetasi B.D. Për këto arsye, në datën 25.08.2016 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të kërkuesve, duke i akuzuar për veprat penale të sipërcituara.

2. Gjykimi i kësaj çështjeje në gjykatën e shkallës së parë rezulton se është zhvilluar me ritin e gjyimit të zakonshëm, megjithëse në datën 20.02.2017, para se të deklarohet i hapur shqyrtimi gjyqësor, kërkuesit kanë kërkuar të procedohet me ritin e gjyimit të shkurtuar, kërkesë me të cilën ka qenë dakord edhe prokurori. Në lidhje me këtë kërkesë, gjykata e shkallës së parë, bazuar në nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka vendosur rrëzimin e saj, duke vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet dhe ishte e nevojshme që provat t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor.

3. Në gjykimin e çështjes, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 105, datë 10.10.2018, ka vendosur: “1. Deklarimin fajtor të kërkuesit Klejvi Doçi për kryerjen e veprave penale “Vrasja me paramendim”, kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës D.S., si edhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit” dhe në zbatim të nenit 55 të KP-së, dënimin e kërkuesit Klejvi Doçi me një dënim të vetëm me 20 (njëzet) vjet burgim. 2. Deklarimin fajtor të kërkuesit Markeljan Doçi, për kryerjen e veprave penale “Vrasja me paramendim”, kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës D.S., “Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, kryer në dëm të viktimës B.S., “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit”(për episodet e datave 06.04.2015 dhe 27.05.2015), dhe në zbatim të nenit 55 të KP-së, dënimin e tij me një dënim të vetëm me 27 (njëzet e shtatë) vjet burgim”. Sipas asaj gjykate u provua tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesit kanë kryer në Seringenplatsoen, Ridderkerk, Holandë, në datën 06.04.2015, vrasjen me armë zjarri të shtetasit shqiptar D.S.

Ndërsa, për sa i përket vrasjes së shtetasit tjetër B.S., gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se veprimet e kryera ndaj viktimës rezultojnë se janë kryer nga kërkuesi Markeljan Doçi, në plotësimin e dy kushteve që parashikojnë mbrojtjen e nevojshme. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë bërë ankim kërkuesit.

4. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 23, datë 13.03.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtin arsyetim. Kundër këtij vendimi kanë bërë rekurs kërkuesit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-427 (62), datë 07.03.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet e ngritura në shkaqet e rekursit nuk janë të tilla që cenojnë vendimmarrjen e gjykatës së apelit, por në rekurs janë parashtruar çështje të ligjit që meritojnë të shqyrtohen në themel, në përputhje me kërkesat e KPP-së. Kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se pretendimet e kërkuesve janë ta pabazuara dhe se ato kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat më të ulëta, duke dhënë dhe arsyetimin e tij për këto pretendime.

6. Në datën 28.09.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 15.10.2024.

II

Pretendimet e kërkuesve

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Deklarimit fajtorë mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi edhe pse gjykata e shkallës së parë ka pranuar papërdorshmërinë e deklarimeve të kërkuesit Klejvi Doçi, dhënë përpara oficerit të Policisë Gjyqësore (OPGJ), vetë ajo, por edhe gjykatat më të larta, e kanë mbështetur vendimin e tyre mbi bazën e provave të tjera, të cilat janë marrë pas ardhjes në dijeni të fakteve të marra në mënyrë të paligjshme. Mbi bazën e deklarimeve të dhëna nga kërkuesi Klejvi Doçi përpara OPGJ-së, pa praninë e mbrojtësit të tij, është vënë në lëvizje organi i akuzës për marrjen e provave të tjera, me qëllim vërtetimin e fajësisë së kërkuesve për ngjarjen e ndodhur në Holandë. Në këtë kuptim, nëse do të ishte respektuar ligji procedural dhe marrja në pyetje e kërkuesit Klejvi Doçi do të ishte kryer në prani të mbrojtësit të tij, ai do të ishte lënë i lirë, pasi nuk kishte lidhje me ngjarjen e ndodhur në Tiranë në datën

27.05.2015, për të cilën ishte ndaluar, për rrjedhojë nuk do të ishte regjistruar as procedimi penal për vrasjen e ndodhur në Holandë. Gjykatat u kanë dhënë vlefshmëri provave të marra pas marrjes së të dhënës të përfutur në mënyrë të paligjshme. Pra, indicja për regjistrimin penal të veprave penale të kryera në Holandë dhe për të kryer hetime për to ishin deklarimet e kërkuarit Klejvi Doçi të marra në mënyrë të paligjshme. Edhe arsyetimi i gjykatave se e drejta procedurale penale parashikon pavlefshmërinë e prejardhur të akteve procedurale dhe jo të provave, në kuptimin që një provë e papërdorshme nuk i bën të tilla edhe provat e tjera të marra në bazë të saj, nuk qëndron dhe është antikushtetues.

7.2. *Së drejtës për të përfutur nga gjykimi i shkurtuar*, pasi gjykata e shkallës së parë edhe pse ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka marrë asnjë provë të re, por është bazuar në provat që ishin mbledhur në fazën paraprake. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë arsye për këtë vendimmarrje.

7.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi rekursi i kërkuarve është shqyrtuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit. Në këtë rast, Gjykata e Lartë ka analizuar vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e gjykimit të shkurtuar, ndërkohë që rekursi i kërkuarve ishte fokusuar te kundërshtimi i vendimit të gjykatës së apelit. Në këtë kuptim, çështja duhej të shqyrtohej në seancë, ku kërkuarit të parashtronin pretendimet e tyre për vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e gjykimit të shkurtuar. Gjykata e Lartë në këtë rast ka marrë në shqyrtim dhe vlerësim një çështje e cila nuk ishte ngritur në rekursin e kërkuarve.

7.4. *Parimit të ligjshmërisë*, pasi për sa kohë kërkuarit kishin paraqitur kërkesa për papërdorshmërinë e provave, argumenti i Gjykatës së Lartë se nuk mund të aplikohet gjykimi i shkurtuar, nuk është ligjor. Në rastin konkret, kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, datë 30.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë””, të ndryshuar (*ligji nr. 35/2017*), që do të thotë se gjykimi është zhvilluar sipas dispozitave të kodit të mëparshëm, ku kërkesa për gjykim të shkurtuar bëhej përpara se të deklarohet i hapur shqyrtimi gjyqësor, që do të thotë se në kërkesa paraprake të pandehurit mund të parashtronin kërkesa për pavlefshmëri apo papërdorshmëri të provave, dhe pasi gjykata të shprehej për këto kërkesa, i pandehuri kishte të drejtë të zgjidhte nëse do të aplikohet gjykimi i shkurtuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuësve

8. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, kërkuësit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuësit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 07.03.2024, i cili sipas informacionit të sjellë nga Gjykata e Lartë është bërë i disponueshëm për palët në datën 31.05.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 28.09.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit 4-mujor.

12. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, kërkuësit kanë pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, për shkak se Gjykata e Lartë e ka zhvilluar gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit, çka, sipas tyre, i ka vënë në pamundësi që të parashtronin pretendimet në lidhje me vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së

parë për mospranimin e gjykimit të shkurtuar, i cili është shqyrtuar nga Kolegji Penal. Në këtë aspekt, Kolegji rithekson qëndrimin e mbajtur nga Gjykata se shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato (palët) nuk janë dëgjuar (*shih vendimet nr. 74, datë 22.10.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, në rastin konkret, Kolegji konstaton se kanë qenë vetë kërkuesit që e kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë, nëpërmjet rekursit të tyre dhe parashtrimeve për detajimin e rekursit, ku, ndër të tjera, kanë ngritur edhe pretendimin e tyre në lidhje me mospranimin nga gjykatat të kërkesës për gjykim të shkurtuar, i cili më pas është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë duke u vlerësuar si i pabazuar. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuesve është haptazi i pabazuar.

13. Kërkuesit kanë pretenduar edhe se janë *deklaruar fajtorë mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, për shkak se gjykatat u kanë dhënë vlefshmëri provave të marra pas marrjes së të dhënës të përfutur në mënyrë të paligjshme dhe se indicia për regjistrimin penal të veprave penale të kryera në Holandë dhe për të kryer hetime për to ishin deklarimet e kërkuesit Klejvi Doçi të marra në mënyrë të paligjshme dhe të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë si të tilla.

14. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesve, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar deklarimet e kërkuesit Klejvi Doçi, të dhëna përpara OPGJ-së në datën 27.05.2015, si të papërdorshme, për shkak se ishin marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga KEDNJ-ja, Kushtetuta, si edhe neni 37 i KPP-së. Po ashtu, në rastin e kërkuesve rezulton se veprimet e përgjimeve ambientale për bisedat e kryera midis tyre, në datat 27.05.2015 dhe 28.05.2015, mbi bazën e të cilave ka filluar hetimi penal për veprat penale të kryera nga kërkuesit në Holandë, janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë si të kryera në përputhje me ligjin procedural, konkretisht me nenet 221, pikat 1, shkronja “a” dhe 3, 222, pika 3 dhe 223, pika 3, të KPP-së. Me vendimet nr. 510, datë 28.05.2015 dhe nr. 511, datë 29.05.2015 të së njëjtës gjykatë, është vleftësuar i ligjshëm urdhri i prokurorit, që ka passjellë edhe përdorimin sipas ligjit të provës të përfutur nga ky veprim procedural. Për rrjedhojë, Kolegji konstaton se edhe pretendimi tjetër i kërkuesve për deklarimin fajtorë mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, është haptazi i pabazuar.

15. Po në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për të përfutur nga gjykimi i shkurtuar, për shkak se gjykata e shkallës së parë edhe pse ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka marrë asnjë provë të re, por është bazuar në provat që ishin mbledhur në fazën paraprake, pa dhënë asnjë arsye për këtë vendimmarrje. Sipas kërkuesve, kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të

ligjit nr. 35/2017, që do të thotë se gjykimi është zhvilluar sipas dispozitave të kodit të mëparshëm. Po ashtu, kërkuesit kanë pretenduar se për sa kohë ata kishin paraqitur kërkesa për papërdorshmërinë e provave, argumenti i Gjykatës së Lartë se nuk mund të aplikohet gjykimi i shkurtuar, nuk është ligjor.

16. Për sa më lart, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo në rastin e akuzave të ngritura kuadër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj, pretendimet e kërkuesve do të trajtohen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimet e mosdënimit pa ligj dhe sigurisë juridike. Si të tilla, këto pretendime *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim për bazueshmërinë e tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimet e mosdënimit pa ligj dhe sigurisë juridike

17. Kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar, për shkak se gjykata e shkallës së parë edhe pse ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që ishin aktet, gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk ka marrë asnjë provë të re, por është bazuar në provat që ishin mbledhur në fazën paraprake, pa dhënë asnjë arsye për këtë vendimmarrje. Sipas kërkuesve, kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, që do të thotë se gjykimi është zhvilluar sipas dispozitave të kodit të mëparshëm. Po ashtu, kërkuesit kanë pretenduar se për sa kohë ata kishin paraqitur kërkesa për papërdorshmërinë e provave, argumenti i Gjykatës së Lartë se nuk mund të aplikohet gjykimi i shkurtuar, nuk është ligjor.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ky detyrim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 16, datë 15.06.2009; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Ashtu sikundër ka pohuar edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk i përket Gjykatës që të shqyrtojë gabime faktike ose juridike që pretendohet se janë bërë nga një juridiksion, me përjashtim të rastit në qoftë se ato mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa e vetëm për aq sa mund t'i kenë cenuar ato (*Streletz, Kessler e Krenz kundër Gjermanisë [DhM], § 49; Vasiliauskas k. Lituaniës [DhM], § 160*), si edhe në qoftë se vlerësimi që kanë bërë juridiksionet kombëtare është haptazi arbitrar (*Kononov kundër Letonisë [DhM], § 189*). Ndonëse Gjykata nuk ka si detyrë që t'u zërë vendin juridiksioneve të brendshme në vlerësimin dhe cilësimin juridik të veprave apo të shprehet rreth përgjegjësisë penale individuale të paditësit (*po aty, § 187; Rohlena kundër Republikës Çeke [DhM], § 51*), funksioni i saj në vështrim të nenit 7 § 1 është të hulumtojë nëse dënimi dhe masa e dënimit që i janë dhënë paditësit mbështeteshin në kohën përkatëse mbi një bazë ligjore. Në veçanti, ajo duhet të sigurohet se rezultati në të cilin kanë dalë juridiksionet e brendshme kompetente ishte në përputhje me nenin 7 të Konventës. Neni 7 do të bëhej pa objekt në qoftë se Gjykatës do t'i jepej një kompetencë kontrolli më pak e gjerë (*po aty, § 52; Kononov kundër Letonisë [DhM], § 198; Vasiliauskas k. Lituaniës [DhM], § 161*). Përveç kësaj, parimi i ligjshmërisë urdhëron që të akuzuarit të mos i jepet një masë dënimi më e rëndë sesa ajo e parashikuar për veprën penale për të cilën ai është njohur fajtor (*Gabbarri Moren kundër Spanjës, §§ 22-34*).

21. Lidhur me procedurën e gjykimit të shkurtuar, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm, i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme dhe eksplicite nga ana e të pandehurit nga disa aspekte themelore të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe ai i formimit të provës në kontradiktoritet, në këmbim të një sërë avantazheve që atij i garantohen nga legjislacioni i brendshëm, pra për të përfituar një ulje të dënimit (*shih vendimin nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ajo ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të

bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, referuar vendimeve gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesit, Kolegji konstaton se ata në datën 20.02.2017, përpara se të deklarohej i hapur shqyrtimi gjyqësor dhe përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, kanë paraqitur kërkesën për të proceduar me gjykim të shkurtuar, me të cilën ka qenë dakord edhe prokurori. Në lidhje me këtë kërkesë, gjykata e shkallës së parë, bazuar në nenin 404 të KPP-së, ka vendosur rrëzimin e saj, duke vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet dhe ishte e nevojshme që provat t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor. Për këtë arsye, çështja është shqyrtuar me gjykim të zakonshëm.

24. Në ankimin e tyre kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkuesit kanë ngritur pretendime edhe në lidhje me refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Këtë pretendim gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar, duke arsyetuar se nuk mund të pranohet gjykimi i shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm, kjo sipas nenit 403, pika 2, të KPP-së (i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017). Sipas gjykatës së apelit, pavarësisht se kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, janë të zbatueshme dispozitat në fuqi, pasi ligjvënësi nuk ka parashikuar ndryshe (*shih faqen 41 të vendimit të gjykatës së apelit*).

25. Pretendimin për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar kërkuesi e ka ngritur edhe në rekurs, për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin. Sipas Kolegjit Penal, ky pretendim (për mospranimin e gjykimit të shkurtuar) është i pabazuar, për shkak se gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë janë ngritur pretendime nga kërkuesit për papërdorshmërinë e provave dhe gjykata i ka marrë parasysh ato, duke konstatuar prova të papërdorshme deklarimet e të gjykuarit Klejvi Doçi – provë e kërkuar nga organi i akuzës. Për të justifikuar pabazueshmërinë e këtij pretendimi, Kolegji Penal i është referuar vendimit unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (referim ky që lidhet me faktin se kërkesa e të gjykuarve është depozituar përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KPP-së), sipas të cilit “[...]gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell përfitim në uljen e 1/3-ës së masës së dënimit. Por, ky përfitim nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë dhe gjykata e pranon atë vetëm kur bindet se çështja mund të përfundojë në gjendjen që janë aktet. Këtij gjykimi, në dallim nga gjykimi i zakonshëm, i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me

pavlefshmerinë e tyre”. Sipas Kolegjit Penal, është praktikë e konsoliduar e Gjykatës së Lartë që gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, në thelb të tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak dhe eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to, pra çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, që nënkupton pranimin e tyre nga palët ashtu sikurse janë dhe se paraqitja e kërkesës nuk çon automatikisht në procedimin me këtë formë gjykimi dhe nuk është as detyruese për gjykatën për ta pranuar. Po ashtu, Kolegji Penal ka vlerësuar se kur vihet në diskutim përdorshmëria e provave të hetimeve paraprake preferohet debati (procesin kontradiktor), si rruga më e sigurt për të shmangur gabimin gjyqësor në cenimin e drejtësisë dhe interesave të ligjshëm të të pandehurit (*shih paragrafët 31.4 dhe 32 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

26. Po ashtu, në rastin e kërkuessve rezulton se veprimet e përgjimeve ambientale për bisedat e kryera midis tyre në datat 27.05.2015 dhe 28.05.2015, mbi bazën e të cilave ka filluar hetimi penal për veprat penale të kryera nga kërkuessit në Holandë, janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë si të kryera në përputhje me ligjin procedural, konkretisht me nenet 221, pikat 1, shkronja “a” dhe 3, 222, pika 3 dhe 223, pika 3, të KPP-së. Me vendimet nr. 510, datë 28.05.2015 dhe nr. 511, datë 29.05.2015 të së njëjtës gjykatë, është vleftësuar i ligjshëm urdhri i prokurorit, që ka passjellë edhe përdorimin sipas ligjit të provës të përfutur nga ky veprim procedural. Për rrjedhojë, Kolegji konstaton se edhe pretendimi tjetër i kërkuessve për deklarimin fajtorë mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, është haptazi i pabazuar.

27. Sipas jurisprudencës së Gjykatës gjykimi i shkurtuar, për nga karakteristikat e tij, hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme. Gjukata është shprehur se neni 404 i KPP-së (sipas përmbajtjes në kohën e paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar) disponon se gjykata e shqyrton kërkesën për gjykim të shkurtuar përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor dhe kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, vendos të pranojë gjykimin e shkurtuar. Në të kundërt, ajo e refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili nëse ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që gjyqtari të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Po ashtu, sipas vendimit unifikues nr. 2/2003 të Gjykatës së Lartë, gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi

gjqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjyimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në 1/3-ës së masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Ky përfitim nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në vështrim të sa më sipër, referuar pretendimeve të kërkuesve për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, Kolegji vëren se gjykatat kanë vlerësuar se çështja e kërkuesve nuk mund të zgjidhet në gjendjen që ndodheshin aktet dhe ishte e nevojshme që provat t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor (gjykata e shkallës së parë), për shkak se prej tyre janë ngritur pretendime për papërdorshmërinë e provave dhe gjykata e shkallës së parë ka konstatuar prova të papërdorshme disa prej tyre (Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë). Pra, në këtë rast kanë qenë vetë kërkuesit të cilët kanë kundërshtuar provat e paraqitura nga organi i akuzës, si pasojë e të cilave gjykatat nuk kanë pranuar gjykimin e shkurtuar. Në vendimin unifikues nr. 2/2003 Gjykata e Lartë është shprehur se këtij gjykimi, në dallim nga gjykimi i zakonshëm, i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre dhe në rast se palët kanë pretendime lidhur me pavlefshmërinë e akteve, qofshin pavlefshmëri absolute apo relative dhe kërkojnë konstatimin apo deklarinimin e kësaj pavlefshmërie, gjykata duhet të revokojë vendimin për gjykim të shkurtuar dhe të urdhërojë vazhdimin e procedimit me gjykim të zakonshëm.

29. Për rrjedhojë, Kolegji evidenton se, sikundër kanë pranuar edhe gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë, procedura e shqyrtimit gjyqësor të çështjes nga gjykata e shkallës së parë si gjykim i zakonshëm ka qenë e domosdoshme, procedurë e ndjekur kjo që me të drejtë ka passjell mospërfitimin nga kërkuesit të uljes së një të tretës së masës së dënimit të caktuar ndaj tyre. Në këtë kuptim, Kolegji arrin në përfundimin se gjykatat në vendimmarrjen e tyre kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me praktikën gjyqësore. Vlerësimi që kanë bërë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në rastin e kërkuesve nuk rezulton të jetë arbitrar. Dënimi i dhënë ndaj tyre është i parashikuar nga legjislacioni penal dhe masa e dënimit nuk është një masë dënimi më e rëndë sesa ajo e parashikuar për veprën penale për të cilën ata janë shpallur fajtorë.

30. Gjithashtu, rezulton se Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim edhe pretendimin e paraqitur në rekurs nga kërkuesit në lidhje me mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar, e ka gjetur atë të pabazuar. Në ushtrim të rolit të saj si gjykatë ligji, ajo ka verifikuar këtë pretendim të ngritur në rekurs, ku përmes argumenteve përkatëse të parashtruara në këtë drejtim ka arritur në përfundimin se gjykatat më të ulëta kanë vepruar në respektim të ligjit, praktikës unifikuese të saj dhe jurisprudencës kushtetuese. Vendimi i

Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë plotëson të gjitha elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuësve për cenimin e procesit të rregullt, për shkak të mospranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, dhe cenimin e ë standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimet e mosdënimit pa ligj dhe sigurisë juridike, janë haptazi të pabazuara, qoftë për sa i përket formës, ashtu edhe përmbajtjes.

31. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuësit nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.